



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.11.2015 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikt i interesit në rastin me nr. AKK -03-02-1303/15, për zyrtarin e lartë z. Bujar Thaçi, Drejtor i Administratës në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në vendimin e tij për emërimin e zyrtares së IKAP – it, znj. Ariana Birinxhiku , në pozitën e zyrtares ndërlidhëse mes IKAP - it dhe ReSPA - së.

II. Agjencia do të kërkoj fillimin e procedurës për kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe në bazë të vendimit Nr. 03-02-1303/15 të AKK-së, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi për zyrtarin e lartë, z. Bujar Thaçi, Drejtor i Administratës në Institutin e Kosovës për Administratë Publike në rastin e emërimit të znj. Ariana Birinxhiku, në pozitën e zyrtares ndërlidhëse mes IKAP – it dhe ReSPA - së, në kohën kur z. Thaçi ishte duke ushtruar funksionin si U.d Kryeshef Ekzekutiv në IKAP.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e gjendjes së konfliktit të interesit sipas të cilit z. Bujar Thaçi gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik si U.d Kryeshef Ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Administratë Publike ka emëruar znj. Ariana Birinxhiku me të cilën ka lidhje familjare (motër e gruas), në pozitën e zyrtares ndërlidhëse në mes të IKAP – it dhe ReSPA – së. Me këtë rast z. Thaçi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia Kundër Korrupsionit për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese z. Thaçi është takuar me zyrtarët e AKK – së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia në këtë rast.

Zyrtari i lartë z. Thaçi, gjatë këtij takimi ka thënë se nuk e ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk e ka ditur se një situatë e tillë mund të jetë konflikt interesi. Mirëpo z. Thaçi ka thënë se kriteret për emërim të zyrtarit ndërlidhës me ReSPA i ka plotësuar vetëm kandidatja e emëruar.

Rrjedhimisht, Ligji nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik në nenin 13 (paragrafi 1), ka përcaktuar obligimin për deklarimin rast për rast të interesave private lidhur me ndonjë vendimarrje të caktuar, të në të cilin shprehimisht thuhet:

“Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në nenin 9 ka përcaktuar veprimet e ndaluara të zyrtarit në të cilin thuhet: “zyrtari i lartë nuk mund të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t’i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm”.

Ndërsa, neni 7 i Ligjit për PKI paragrafi 8 ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë në të cilin shprehimisht thuhet: “zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm”.

Andaj, në këtë rast z. Thaçi, në rastin e marrjes së vendimit nuk e ka deklaruar dhe shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, “çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

